



FORÇA JONË

* * * Viti II • Nr. 18 • Nëntor 2013 • Ministria për Forcën e Sigurisë të Republikës së Kosovës * * *

Është mbajtur ushtrimi fushor "Shqiponja -2"

FSK-ja demonstroi nivel të lartë të mobilizimit, përkushtimit dhe profesionalizmit

Qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor "Shqiponja 2" ishte që të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren.

Për të përcjellë ushtrimin e FSK-së në kazermën "Ushtarët e NATO-s" në Istog, morën pjesë: presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga, zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi e Bejtush Gashi, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, zëvendës komandanti i FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Rama, gjeneralët e FSK-së dhe stafi më i lartë i Ministrisë dhe FSK-së, përfaqësues të KFOR-it, shefi i Ekipit Ndërlidhës dhe Këshillues i NATO-s, gjeneral Norbert Wagner, atashë ushtarak të akredituar në Prishtinë dhe oficerë të lartë të FSK-së, përfaqësues të Komisionit Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së. Fillimisht, presidentja Jahjaga është pritur në kazermën "Ushtarët e NATO-së" në Istog nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Më pas, shefi i

Shtabit të Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së, kolonel Naim Hazi, e njoftoi Presidenten dhe mysafirët e lartë me skenarin dhe objektivat e ushtrimit fushor "Shqiponja 2". Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, përcolli ushtrimin në disa pika, si: Intervenimin e pjesëtarëve të Mbrojtjes Kimiko-Atomike Biologjike (MKAB)), të kërkimshpëtimit, deminimit dhe të mbrojtja e konvojit. Me këtë rast, presidentja e Kosovës, zonja Jahjaga i përgëzoi drejtuesit e FSK-së, oficerët dhe ushtarët për angazhimin e tyre në realizimin e ushtrimit fushor "Shqiponja 2". Në fjalën saj, presidentja Jahjaga, ndër të tjera, tha: "FSK-ja dha një dëshmi të qartë për nivelin e profesionalizmit dhe të përgatitjes profesionale që ka arritur deri tash. Në veçanti falënderoj Gardën Kombëtare të Ajovës, pjesëtarët e Ushtrisë

amerikane dhe pjesëtarët e KFOR-it, të cilët kanë ndihmuar dhe po ndihmojnë në mënyrë të vazhdueshme avancimin dhe përgatitjen profesionale të FSK-së". Në emër të Ministrisë së FSK-së, të pranishmit i përshëndeti zëvendësministri Muhamet Latifi, i cili falënderoi pjesëtarët e FSK-së, të KFOR-it dhe të Ushtrisë amerikane, për realizimin me sukses të ushtrimit fushor "Shqiponja 2". Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, në fjalën e tij përshëndeti pjesëtarët e FSK-së, për realizimin e këtij ushtrimi gjithëpërfshirës, KFOR-in, për ndihmën profesionale dhe sidomos Ushtrinë amerikane dhe Gardën Kombëtare të Ajovës. Gjeneral Kastrati, me këtë rast tha: "Stërvitja e pjesëtarëve dhe e njësive të FSK-së, është objektiv dhe prioritet kyç i imi dhe i komandantëve në të gjitha nivelet. Ushtrimi



fushor „Shqiponja 2“ është finalizim i suksesshëm i ciklit të stërvitjeve individuale dhe kolektive të FSK-së, për këtë vit. FSK-ja realizim e ushtrimit fushor e ka filluar më 3 tetor dhe ka vazhduar pandërprerë për 8 ditë me radhë, ku janë angazhuar 1951 pjesëtarë me 161 automjete. Ushtrimi u zhvillua në pjesën perëndimore të Republikës së Kosovës, kryesisht në Regjionin e Pejës dhe Prizrenit. Qëllimi i ushtrimit fushor

"Shqiponja 2" ishte që të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të njësive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren. Komandant Kastrati përgëzoi veçanërisht ushtarët, nënoficerët dhe oficerët të cilët treguan profesionalizëm, vullnet dhe disiplinë për të realizuar të gjitha objektivat e parashikuara të ushtrimit.

Suedia mbështet FSK-në dhe Kosovën

Zëvendësministri i FSK-së, z. Muhamet Latifi së bashku me komandantin e FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastratin, kanë pritë, në një takim zyrtar, ministrin e Mbrojtjes të Suedisë, zonjën Karin Enstrom me bashkëpunëtorë. Ministria e Mbrojtjes së Suedisë u prit me nderimet më të larta nga Njësia Ceremoniale dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Fillimisht, zëvendësministri Latifi dhe ministria Enstrom biseduan kokë më kokë, për të vazhduar më pastaj takimin e përbashkët në mes të dy delegacioneve.




Zëvendësministri i FSK-së, Muhamet Latifi, e falënderoj Qeverinë e Suedisë dhe personalisht Ministrin Karin Enstrom, për ndihmën e veçantë dhe të vazhdueshme që kanë dhënë dhe po japin për Forcën e Sigurisë së Kosovës. Suedia është një nga vendet që ka kontribuar shumë për FSK-në. Zëvendësministri Muhamet Latifi, për të pranishmit u shpreh se ky takim kishte karakter pune, ku e informova ministrin Enstrom me zhvillimin e përgjithshëm të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, me objektivat e Ministrisë, me progresin e arritur, bashkëpunimin si dhe procesin e Rishikimit të Sektorit të Sigurisë. Në fund, ai tha se janë akorduar me ministrin e Suedisë që të konkretizohen fushat specifike të bashkëpunimit dhe të nënshkruajë së bashku një memorandum mirëkuptimi. Ministria e Mbrojtjes së Suedisë, zonja Karin Enstrom, u shpreh: "Për mua është kënaqësi e veçantë që jam për vizitë në Prishtinë dhe në FSK. Ne biseduam me zëvendësministrin dhe komandantin e FSK-së, për vazhdimin dhe thellimin e këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Për ne është në interes ta mbështesim Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Kosovën në tërësi në mënyra të ndryshme. Ne, kemi diskutuar se si të gjejmë mënyra të

bashkëpunimit për ta ndihmuar Qendrën Ekselence të Kërkim-Shpëtimit dhe gjithashtu kemi biseduar edhe për projekte tjera të përbashkëta", ka thënë, zj. Enstrom. Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati e njoftoi ministrin e Mbrojtjes së Suedisë, zj. Karin Enstrom dhe delegacionin e Suedisë, për të arriturat e përgjithshme të FSK-së; plotësimin e kapaciteteve të përgjithshme operacionale, shkollimin, trajnimet, bashkëpunimin e mirë që kanë me shtetet rajonale si dhe me Shtetet e Bashkuara të Amerikës e veçanërisht me Gardën Kombëtare të Ajovës, e njoftoi për pjesëmarrjen e FSK-së, në trajnimet rajonale, për operacionet e kryera nga Kompania e Deminimit, Kërkim-Shpëtimit, si dhe projektet humanitare dhe për projektet e planifikuara për të ardhmen. Gjeneral Kastrati, edhe kësaj radhe, kërkoi ndihmën e Armatës së Suedisë (me mjete të rënda-ekska-vator kundër minave) për pastrimin edhe të tri objekteve të minuara dhe të shkatërruara gjatë luftës, siç janë; Kazerma "Adem Jashari" në Prishtinë, në Llukar dhe afër Aeroportit të Prishtinës, në Sllatinë.

Gjeneralmajor Rama: "Shqiponja 2", ishte sfidues i të gjitha njësive të FSK-së në terren

Zëvendës komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjeneralmajor Rrahman Rama, njëherësh komandant i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), për ushtrimin fushor "Shqiponja 2" tha: Niveli i gatishmërisë së pjesëtarëve të FSK-së, gjatë mbajtjes së ushtrimit fushor "Shqiponja 2", ishte i lartë, ndërsa angazhimi dhe disiplina ishin në nivelin e duhur. Kjo ka bërë që pjesëtarët e njësive të specializuara të përshatën plotësisht me rrethanat e reja që janë krijuar gjatë ushtrimit në terren. Për ne me rëndësi ka qenë procesi i vendimmarrjes, i cili është realizuar me sukses sipas skenarit paraprak. Po ashtu është arritur edhe qëllimi im që të sfidohen të gjitha njësitet, duke i spikatur kështu anë e tyre të forta dhe duke i identifikuar dobësitë që duhet të përmirësohen, si: shkathtësitë individuale, kolektive dhe mbështetjen e nevojshme për operim. Ky qëllim është arritur, por tani fillon puna kryesore; "Këto mësimë të mësuara duhet të inkuropohen në plan dhe të elimino-hen mangësitë që kemi pasur si dhe të mirëmbajmë ato shkathtësi



me të cilat qëndrojmë mirë. Gjatë ushtrimit fushor "Shqiponja 2" treguam se kemi kapacitete dhe aftësi për përmbushjen e misionit që kemi dhe se jemi të gatshëm për misione të tjera në të ardhshmen. Megjithatë, nuk duhet të vetëkënaqemi por të vazhdojmë të punojmë që në të ardhmen të jemi më të përgatitur në planet rezervë. Komanda e Forcave Tokësore (KFT) duhet të jetë gjithmonë një hap përpara, si në përcjelljen e operacioneve ashtu edhe në reagimin e kërkesave që vijnë nga poshtë. Vitin e ardhshëm, një periudhë kohore duhet ta rezervojmë për trajnime të përbashkëta në mes të gjitha njësive të FSK-së, në mënyrë që të arrihet bashkëveprimi dhe ndërveprimi në mes njësive".

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati ka takuar Nexhdet Ozelin, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë

Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë vazhdojnë ta përkrahin FSK-në

Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtnant Kadri Kastrati priti në takim në Ministrinë e Forcës së Sigurisë gjeneralin me katër yje Nexhdet Ozel (Necdet Ozel), shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Turqisë.

Gjenerallejtnant Kadri Kastrati e njoftoj shefin e Ushtrisë së Turqisë mbi ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së për këtë periudhë pesëvjeçare; e njoftoj mbi strukturën, detyrat e FSK-së, si edhe objektivat e saj për të ardhmen. Gjeneral Kastrati tha se FSK-ja ndër të tjera është duke kryer suksesshëm operacione të deminimit, operacione humanitare në dobi të gjithë qytetarëve të Kosovës, gjithashtu FSK-ja në vazhdimësi është duke asistuar në ndihmë mjekësore popullatën në zonat rurale ku jetojnë pjesëtarë të komuniteteve. Komandanti i FSK-së, gjithashtu para gjenerali Ozel shpalosi edhe objektivat e Ministrisë dhe Forcës, Ai tha se qëllimi ynë është që FSK-ja të ngrihet profesionalisht edhe në nivel më të lartë, të jetë e disiplinuar, shumetnike dhe e dislokueshme. Kosova, shtoi më tej gjeneral Kastrati, është në proces të Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë dhe me këtë edhe të FSK-së. Synojmë që FSK-në ta bëjmë një Forcë e cila do t'ju përgjigjet nevojave të Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj, si edhe ta bëjmë një institucion me mision adekuat, që do të jetë Forcë

për të mirë në rajon dhe partnere e denjë e NATO-s dhe shteteve anëtare të saj.

Gjeneral Kastrati, gjithashtu në kuadër të bashkëpunimeve bilaterale që ka Ministria e FSK-së me shumë shtete, u ndal te bashkëpunimi shumë i frytshëm që FSK-ja ka me Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë. Me këtë rast komandant Kastrati tha se në kuadër të FSK-së kemi 2,36 për qind pjesëtarë të komuniteti turk që jeton në Kosovë, kemi laborator të gjuhës turke të realizuar në bashkëpunim me FA të Turqisë. Gjithashtu, gjeneral Kastrati e falënderoi shefin e FA-së të Turqisë për mundësitë e tyre të ofruara për shkollimin e kadetëve të FSK-së në Turqi, e në kuadër të kësaj edhe në Kolegjin e Luftës. Po ashtu, gjeneral Kastrati e falënderoi gjeneralin Ozel edhe për pajisje që ushtria e tij i ka ofruar për FSK-në. Ai njëherësh kërkoi nga FA-të e Turqisë që të vazhdojnë ta mbështesin FSK-në, në qëllimin e saj, për zbatim të jashtë vendit në misionet paqësore.

Nga ana e tij Nexhdet Ozel, shef i FA të Turqisë, pasi shprehu kënaqësinë për ftesën e bërë nga FSK-ja dhe për vizitën që po realizon, duke shtuar se ndjehet "si në mes vëllezërish". Gjeneral Ozel shprehu gatishmërinë e tij dhe të Forcave të Armatosura të Turqisë se do të vazhdojnë të japin përkrahje FSK-së në mënyrë që siç tha Ai, FSK-ja të jetë e përparuar dhe profesionale. Shefi i FA të Turqisë,



gjithashtu, përgëzoi gjeneral Kastratin për arritjen dhe njohjen nga NATO-ja të Kapaciteteve të Plota Operacionale për FSK-në. Përveç që ne jemi mentorues tha gjeneral Ozel, ne dëshirojmë që të zhvillojmë operacione stërvitore të përbashkëta. Ne tha gjeneral Ozel jemi duke iu dhënë mbështetjen e duhur dhe konkrete, dhe se ne me shumë vëmendje përcjellim Planin e NATO-s për mbështetje të FSK-së. Në fund gjenerali Ozel tha se Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë mbështesin FSK-në në synimin e saj për të marrë pjesë në operacione të paqes.

Në takimin e përbashkët të të dyja delegacioneve morën pjesë edhe gjeneral major Rrahman Ramazëvendëskomandant i FSK-së dhe komandanti i Komandës së Forcave

Tokësore (KFT), Shkelzen Sylajsekretar i përgjithshëm në Ministri, gjeneral brigade Zymer Halimidrejtor i Drejtorisë së Operacioneve, gjeneral brigade Bashkim Jashari-drejtor i Inspektoratit të FSK-së, Haxhi Shaladrejtor i Drejtorisë për Politika dhe Plane, gjeneral brigade Gëzim Hazrolli-zëvendëskomandant i KFT-së dhe nënkolonel Hasan Hoxha-shef i Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri. Ndërsa nga ana e delegacionit të Republikës së Turqisë ishin; ambasadorja e Republikës së Turqisë në Kosovë, Songul Ozan, kolonel Zorlu Topaloglu, kolonel Sevket Cumaoglu, kolonel Erdal Dodurga, kolonel Fedai Unsal, kolonel Muammer Aygar, kolonel Hasan Aydogdu, Ahenk Dereli.

Komandanti i FSK-së takoi përfaqësuesit e tri delegacioneve të Ushtrisë së Kroacisë

Tri delegacione të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Ushtrisë së Kroacisë, ishin për vizitë pune treditore (16, 17 dhe 18 tetor 2013) në Ministrinë e FSK-së dhe në Komandën e Forcave Tokësore (KFT).

Kjo vizitë realizohet në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Bilateral në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe të Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë, për vitin 2013.

Qëllimi i vizitës së delegacioneve të Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë, është vazhdimi i bashkëpunimit të dyanshëm si dhe shkëmbimi i përvojave dhe të njohurive në fushat përkatëse. Fillimisht, mysafirët nga Kroacia i priti komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, i cili pasi që ju uroj mirëseardhjeje e falënderoi Kroacinë për mbështetjen e saj të vazhdueshme për FSK-në. Gjeneral Kastrati, me këtë rast, e njoftoi delegacionin e Kroacisë me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, bashkëpunimin rajonal dhe në veçanti bashkëpunim me SHBA-n, shkollimin, trajnimet si dhe për Rishikimin e Sektorit Strategjik të Sigurisë për FSK-në.

Delegacioni i Kroacisë u pritë në takime të ndara pune edhe në Departamentin për Siguri dhe Bashkëpunim në MFSK-së, ku me nënkolonel Hasan Hoxha, shef i këtij departamenti, diskutuan rreth përvojave të mira të Ministrisë së Mbrojtjes së Kroacisë, në procesin drejt anëtarësimit në NATO dhe mekanizma të tjerë, ndërsa në Departamentin për Politika dhe Plane me z. Faruk Gecin, shef i këtij departamenti, biseduan për fushat me rëndësi të veçantë për MFSK-në dhe FSK-në. Ndërsa, dy delegacionet e tjera të Ushtrisë së Kroacisë vazhduan aktivitetet e tyre, njëri në kazermën "Usharët e NATO-s" të BRSH-së në Istog dhe delegacioni tjetër në Komandën e Forcave Tokësore, përkatësisht në Policinë Ushtarake të FSK-së. Në fund të takimit treditore të dy delegacionet u akorduan për mënyrat e bashkëpunimit në mes departamenteve përkatëse, për formën e realizimit dhe thellimin e këtij bashkëpunimit, me qëllim të përfitimit të njohurive dhe eksperiencave të dyanshme.



Mirënjohje për këshilltarët e MCAD-it dhe të KFOR-it

Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore (KFT), me rastin e përfundimit të punës së këshilltarëve të MCAD-s, (Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s) në FSK, u organizua një takim ceremonial, ku morën pjesë; zëvendësministri i MFSK-së, Muhamet Latifi dhe Bejtush Gashi, komandanti dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati dhe gjeneralmajor Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Salvatore Farina, drejtori i NLAT-it (ekipi këshillues-ndërlidhës) gjeneralbrigade Wagner, si dhe oficerë të lartë të FSK-së dhe KFOR-it.

Komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, pasi përshëndeti komandantin e KFOR-it, gjeneralin Farina dhe gjeneralin Norbert Wagner, si dhe të gjithë oficerët e FSK-së dhe KFOR-it, falënderoi në mënyrë të veçantë përfaqësuesit e MCAD-it, (Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s) në FSK-



në, për punën e tyre profesionale dhe për angazhimin dhe kontributin e tyre të dhënë në ngritjen e kapaciteteve operacionale të FSK-së, gjatë këtyre pesë viteve, të cilët janë pjesë e suksesit të FSK-së.

Me këtë rast, gjeneral Kastrati tha se MCAD-ja e ka ndihmuar vazhdimisht FSK-në, ku fokusi kryesor ka qenë ofrimi i trajnimeve në nivel individ dhe njësie. Më vonë, fokusi u zhvendos nga trajnimet për mentorimin dhe këshillimin e FSK-së në operacione, rekrutime, trajnime, logjistikë dhe çështje të tjera. Më tej gjeneral Kastrati tha se FSK-

ja dhe Ai personalisht vlerësojnë përpjekjet e KFOR-it, në zhvillimin e FSK-së në një forcë profesionale dhe kompetente që e pavarur mund të përmbushë detyrat e veta. Suksesi i FSK-së është suksesi ynë i përbashkët, dhe të arriturat e FSK-së janë të arriturat tona të përbashkëta me përfaqësuesit e MCAD-së. Në korrik, NATO ka deklaruar Plotësimin e Kapaciteteve Operacionale për FSK-në. Kjo do të thotë se

FSK-ja është plotësisht e aftë për të kryer detyrat e përcaktuara sipas misionit dhe po shihet edhe nga partnerët tanë si një partner i besueshëm. Që nga themelimi, FSK-ja, bazuar në zhvillimin e saj, ka përdor praktikë më të mira demokratike, me mbështetjen nga aleatët e NATO-s. Ne jemi krenarë për arritjet tona, dhe do të vazhdojmë ta zhvillojmë FSK-në në një forcë që ofron mbështetje për të gjithë qytetarët tanë dhe asistencë për të gjithë në vend dhe rajon. Më pastaj, komandanti i FSK-së tha se

ne vazhdojmë përpara për të zhvilluar marrëdhëniet tona profesionale me KFOR-in dhe ndërtimin e të ardhmes tonë me Ekipin Këshillues-ndërlidhës të NATO-s. Ndërsa, drejtori i NLAT-it (Ekipi Ndërlidhës Këshillues), gjeneralbrigade Norbert Wagner, ka përgëzuar për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, me theks të veçantë integrimin e përfaqësuesve të komuniteteve. Në fund, gjenerali Wagner premti se edhe në të ardhmen do ta ndihmojmë FSK-në përmes këshillimeve profesionale.

Në fund, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Kadri Kastrati, së bashku me zëvendëskomandantin e FSK-së, gjeneralmajor Rrahman Ramën, komandantin e KFOR-it, gjeneralbrigade Salvatore Farina dhe drejtorin e NLAT-it, gjeneralin Wagner, ndanë mirënjohje për përfaqësuesit e Divizionit Këshillues Ushtarako-Civil të NATO-s, (MCAD) me motivacionin për shërbim dhe për kontributin e dhënë në zhvillimin e FSK-së në një forcë kompetente.

FSK-ja në alarm, për ushtrimin fushor "Shqiponja 2"

Gjeneralmajor Rrahman Rama, zëvendëskomandant i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), përkatësisht komandanti i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), që nga orët e hershme të mëngjesit të datës 3 tetor, me urdhër të veçantë, alarmoi të gjitha njësitë e KFT-së, për gjendje gatishmërie, me rastin e zhvillimit të ushtrimit fushor "Shqiponja 2". Qëllimi i FSK-së është që nëpërmjet ushtrimit "Shqiponja 2" të testohen aftësitë komanduese, reaguese dhe koordinuese të një-sive, shtabeve dhe pjesëtarëve në operacione të planifikuara dhe me skenar adekuat për matjen e efikasitetit të reagimit në terren. Sipas misionit të tyre, në ushtrim do të jenë të përfshirë; Komanda e Forcave Tokësore, Brigada për Reagim të Shpejtë me tri batalionet e Reagimit të Shpejtë,

Brigada për Mbështetje Operacionale me Regjimentin për Mbrojtje Civile, Batalioni i Xhenios dhe i Logjistikës, Komanda e Doktrinës dhe Stërviçes, si edhe njësitë vartëse të KFT-së; Njësia Ndërlidhëse për Reagim ndaj Krizave, Policia e Forcës, Kompania e Komunikimit dhe Kompania e Mjekësisë. Konvojet e Forcës së Sigurisë së Kosovës do të marshojnë nga vendbazimet e tyre nga Prishtina, Ferizaj, Gjilani, Mitrovica, dhe Pomozotini për në rajonet e grumbullimit, ku aktiviteti do të jetë i përqendruar në komunat: Pejë, Istog, Prizren dhe Klinë. Për këtë qëllim FSK-ja ka bërë të gjitha përgatitjet dhe marrëveshjet paraprake me komunat dhe të gjitha institucionet që do të jenë pjesë e këtij ushtrimi, me qëllim



që mbarëvajtja e ushtrimit të zhvillohet sipas planifikimeve. Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Forca e Sigurisë së Kosovës njoftojnë opinionin e

gjërë dhe gjithë qytetarët se lëvizjet e konvojeve të FSK-së do të bëhen për qëllim ushtrimi. Pra dislokimi i njësive dhe lëvizja e konvojeve në rrugët magjis-

trale dhe lokale do të vërehen që nga 3 tetori, për dhjetë ditë me radhë, gjatë 24 orëve dhe do të bëhen vetëm për qëllime ushtrimi.

Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios përfundojnë me sukses projektin për "Përmirësimin e Poligonit të Kalitjes Fizike"

Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes të FSK-së (KDS), gjeneralbrigade Enver Cikaçi së bashku me komandantin e Batalionit të Xhenios, nënkolonel Zejnullah Prokshi si dhe oficerin komandues të ekipit mentorues, kapiten Michael Parton, certifikuan pjesëtarët e Batalionit të Xhenios të FSK-së, për përfundimin e punimeve, gjatë katër javëve, në përmirësimin e Poligonit të Kalitjes Fizike, më 4 tetor 2013, në Ferizaj.



Gjeneralbrigade Enver Cikaçi i përgëzoi pjesëtarët e FSK-së, për punën dhe profesionalizmin e tyre, si dhe për përkushtimin në realizimin e detyrave me shumë përgjegjësi. Ai, po ashtu e falënderoi edhe kapitenin Parton, për bashkëpunimin e pjesëtarëve

Britanezë me pjesëtarët e FSK-së. "Pjesëtarët e Batalionit të Xhenios kanë fituar përvojë shumë të nevojshme për projektet e ardhshme, ku kanë përvetësuar aftësi në aspektin teknik profesional të in-

hinierisë, po ashtu edhe në menaxhimin e projekteve në tërësi. Gjithashtu përvoja e fituar në këtë projekt për ndërtimin e poligoneve do të na shërbejë edhe për ndërtimin e poligoneve tjera

dhe atyre 300 m", tha gjeneralbrigade Enver Cikaçi.

Projekti për Përmirësimin e Poligonit të Kalitjes Fizike ka qenë i domosdoshëm për trajnimet fizike të cilat kryhen në KDS, në Ferizaj. Plani i detajuar për realizimin e këtij projekti është ofruar nga inxhinierët e Ushtrisë së Mbretërisë së Bashkuar, të cilët kanë asistuar për 4 javë rresht implementimin e këtij projekti ku kanë qenë të angazhuar 17 pjesëtarë të Batalionit të Xhenios së FSK-së.

Oficeri komandues i ekipit mentorues, kapiteni Michael Parton, u shpreh shumë i kënaqur me bashkëpunimin me pjesëtarët e FSK-së. Ai, theksoi se bashkëpunimi dhe mikpritja e FSK-së, janë shembulli më i mirë që kanë

pasur deri me tani me ushtritë tjera. "Ne nga ushtria britaneze kemi përvojë bashkëpunimi me ushtritë nga vende të ndryshme të botës, por ju siguroj se mikpritjen që kemi gjetur në FSK, nuk e kemi gjetur askund tjetër. Ju falënderoj për entuziazmin dhe përkushtimin që treguat gjatë këtij trajnimit. Ju keni qenë jashtëzakonisht pozitiv në të gjitha aspektet, andaj ju bëj thirrje për të vënë aftësitë tuaja të reja në praktikë" përfundoi kapiteni Parton.

Ky projekt ka përfshirë heqjen e 6 pengesave, përmirësimin e 12 të tjerave si dhe ndërtimin e 4 pengesave të reja. Janë përfshirë lëmi të inxhinierisë, murimit, vendosja e anësoreve, ndërtimi i themeleve, demolimi i masave të betonit, saldimi i pengesave, etj.

Departamenti për Inspektimë i Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë dhe Inspektorati i FSK-së, thellojnë bashkëpunimin

Një delegacion i Departamentit për Inspektimë të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë, i udhëhequr nga shefi i këtij departamenti, z. Pero Petrovski, qëndroi për vizitë zyrtare dyditore (8 dhe 9 tetor 2013) në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ky takim u realizua në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Bilateral në mes Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, për vitin 2013.

Qëllimi i vizitës po edhe i takimeve ishte vazhdimi i

bashkëpunimit të dyanshëm, shkëmbimi i përvojave dhe të njohurive në fushën e inspektoratit. Delegacioni i Maqedonisë, në Ministrinë e FSK-së, u prit nga nënkolonel Agim Vrellaku. Inspektori i FSK-së me bashkëpunëtorë i njoftoi mysafirët për strukturën, misionin, funksionet dhe aktivitetet e Inspektoratit të FSK-së, në përgjithësi.

Delegacioni i Inspektoratit të Ushtrisë së Maqedonisë, gjatë qëndrimit në Kosovë, ditën e dytë, vizitoi edhe Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes të FSK-së në Ferizaj, ku u prit nga zëvendëskomandanti, kolonel



Irfete Spahiu. Kolonel Spahiu, gjithashtu i njoftoi mysafirët me organizimin e

Komandës së Doktrinës dhe Stërviçes, me aktivitetet e përgjithshme që mbahen në KDS,

si dhe me kapacitetet që ka kjo qendër trajnuese.

Gjatë këtij takimi të dy delegacionet biseduan edhe për mënyrat e bashkëpunimit të mëtejshme në mes të Inspektoratit të MFSK-së dhe Departamentit të Inspektoratit të Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë, për formën e realizimit dhe thellimin e këtij bashkëpunimi, me qëllim që të përfitohen njohuri dhe eksperiencia të dyanshme.

Delegacioni i inspektorëve nga Maqedonia, në fund, vizitoi Qendrën e Stërviçes dhe Qendrën e Trajnimit, ku u informua nga afër me trajnimet që ofrojnë këto qendra të KDS-së.

Intervistë me drejtorin e ushtrimit fushor "Shqiponja 2" kolonel Naim Hazirin

FSK-ja me sukses realizoi ushtrimin fushor "Shqiponja 2"



"Forca Jonë": Zotëri kolonel, cili ishte qëllimi i mbajtjes së ushtrimit fushor "Shqiponja 2"?

Kolonel Naim Haziri: Mbjajtjen e ushtrimit fushor, ka përqendrimin zhvillimin dhe mirëmbajtjen e kapaciteteve operacionale nga njësitë, si të nivelit taktik ashtu edhe operativ, që nga organizimi, planifikimi, drejtimi i veprimeve dhe zbatimi i procedurave, duke nisur nga marrja e alarmit, ekzekutimi i operacioneve e deri tek përfundimi i ushtrimit. Ushtrimi është mbajtur me qëllim që të realizohen objektivat e parapara paraprakisht sipas Direktivës së Komandantit të FSK-së, siç janë: planifikimi, organizimi, koordinimi, realizimi dhe vlerësimi i ushtrimit; zbatimi i procedurave të alarmimit, grumbullimi, lëvizja, reagimi dhe ri-dislokimi; zbatimi i procesit të vendim-marrjes; zbatimi i komandimit, kontrollit dhe komunikimit; zbatimi i procedurave të mbështetjes administrative dhe logjistike; zbatimi i stërvitjeve në kushte të vështira të shikueshmërisë dhe eliminimi i mangësive nga ushtrimet e kaluara.

"Forca Jonë": Kur i kemi filluar përgatitjet për realizimin e ushtrimit fushor?

Kolonel Naim Haziri: Mbjajtja e ushtrimit fushor ka qenë e planifikuar sipas planeve vjetore, të trajnimeve, për vitin 2013, dhe këtë e ka aprovuar komandanti i Forcës së Sigurisë të Kosovës, gjenerallejtënant Kadri Kastrati. Në muajin prill është lëshuar Direktiva e Komandantit të Forcave Tokësore (KOMFT), ku janë specifikuar të dhënat e përgjithshme për ushtrimin, si: qëllimi, objektivat, koncepti i realizimit të ushtrimit dhe ndarja e përgjegjësiave, për fazën planifikuese dhe për fazën e realizimit. Në funksion të kësaj, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, më ka ngarkuar me detyrën e drejtorit të ushtrimit, me qëllim të koordinimit të gjitha aktiviteteve në fazën e planifikimit dhe realizimit sipas specifikave të



caktuara dhe analizën pas veprimit të ushtrimit. Në proces të planifikimit janë realizuar 4 konferenca; më 12 qershor, është realizuar Konferenca e Specifikimeve Teknike, më 2 korrik, Konferenca Filestare e Planifikimit (KFP), më 5 gusht, Konferenca Kryesore e Planifikimit (KKP) dhe më 30 gusht, Konferenca Përfundimtare Koordinuese. Gjithashtu, në funksion të saj, kemi realizuar edhe dy ushtrime paraprake, një në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) në Qendrën e Trajnimit Kolektiv (QTK) në Ferizaj, ku kemi realizuar Procesin e Marrjes së Vendimeve Ushtarake (PMVU), më 02-06 shtator dhe ushtrimi në Vend-Komandë pa Trupa (UVK), më 23-27 shtator 2013.

"Forca Jonë": Cili ishte skenari i ushtrimit?

Kolonel Naim Haziri: Situata ka qenë e dizajnuar në atë mënyrë që njësitë tona të kenë mundësi që të reagojnë në përputhje me misionin, duke u ballafaquar me të gjitha sfidat. Sipas skenarit, Republikën e Kosovës muajt e fundit e ka përfshirë një mot i lig të përcjellë me reshje të rrëmbyeshme dhe me shtërngata, këto kryesisht kanë qenë të theksuara në pjesën jug-perëndimore të Kosovës, kryesisht në regjionin e Prizrenit dhe të Pejës, ku si pasojë e motit të lig, kemi pas dëmtime të infrastrukturës,

turës, përmbyetje të shumta, zhvendosje të qytetarëve nga pronat, zhdrukje të qytetarëve, plaçkitje, zjarre, fusha të minuara, paraqitje të epidemive, etj. Në këtë rast, autoritetet civile emergjente kanë dështuar të ballafaqohen me situatën, andaj Qeveria e Republikës së Kosovës ka kërkuar që FSK-ja të ngritë gatishmëri dhe të jetë e gatshme për të mbështetur autoritetet lokale në menaxhimin e situatës në terren.

"Forca Jonë": Sa ishte FSK-ja e përgatitur për t'ju përgjigjur alarmit dhe situatës në terren?

Kolonel Naim Haziri: Në përgjigje të kërkesës së Qeverisë së Kosovës, ne kemi lëshuar urdhrin e parë paralajmërues, më 03.10.2013, për ngritje të gatishmërisë dhe për reagim në vendndodhje. Ne jemi të kënaqur për këtë, sepse pjesëtarët tanë 92%, pas dhënies së alarmit, kanë qenë në vendbazimet e tyre të përhershme. Brigadat dhe batalionet kanë filluar me procesin e planifikimit, për t'u ballafaquar me situatën e krijuar, në përputhje me listën e detyrave esenciale për zbatim të misionit në terren.

"Forca Jonë": Zotëri kolonel, cili ka qenë koncepti i përgjithshëm i ushtrimit fushor?

Kolonel Naim Haziri: Koncepti i përgjithshëm i ushtrimit fushor

(UF) ka qenë i fokusuar mbi bazën e kërkesave të mundshme për mbështetje në situata krize, ku përmes këtij ushtrimi bëhet përgatitja e njësitë të FSK-së në nivelin operativ-taktik, me mundësi vlerësimi në fusha të caktuara specifike. Ushtrimi ka qenë i simuluar me situata sa më reale, për të sfiduar njësitë e FSK-së në simulimin e situatave, siç ishte Batalioni i Parë i BRSH-së, i komanduar nga major Haki Xhemajli, si forcë opozitare. Angazhimi i njësitë të FSK-së, ka qenë i kombinuar. Koncepti i operacionit të ushtrimit fushor "Shqiponja 2" është realizuar në 4 faza:

Faza Parë Misioni

Kjo fazë ka filluar me publikimin e planit operacional dhe ka vazhduar deri tek kalimi në fazën e dislokimit. Përgjatë kësaj faze njësitë e KFT-së kanë zhvilluar dhe rishikuar planet mbështetëse dhe procedurat, kanë testuar dhe bërë provat përfundimtare para zbrakues, marrjen e masave dhe informimin e personelit me detyrat e tyre.

Faza e Dytë; Dislokimi i njësitë në vendincidente

Kjo fazë ka filluar me ngritjen e Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO). Kjo qendër është formuar nga shtabet e dy brigadave, Brigadës për Reagim të Shpejtë dhe Brigadës së Mbështetjes Operacionale dhe është komanduar nga komandanti i BRSH-së, gjeneralbrigade Nazmi Brahimaj. Lëvizjen e njësitë nga bazat e përhershme drejt zonës së grumbullimit dhe ngritjes së bazave të përpamjeve, përgatitjeve për operim dhe ekzekutim të operacioneve. Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) ka operuar në zonat vijuese të përgjegjësisë: Zonën Operacionale (ALFA) në Istog, ku kemi pas të vendosur një batalion

plus dhe është komanduar nga nënkolonel Mehmet Lladrofti, si dhe Zonën Operacionale (BRAVO) në Prizren, gjithashtu një batalion plus dhe është komanduar nga nënkolonel Arsim Shaqiri.

Faza e Tretë- Reagimi në situata

Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) ka organizuar të gjitha forcat me personel dhe me pajisje, në të dy bazat e përpamjeve operacionale, për reagim në vendincidente. Njësitë në vartësi të QBO-së, kanë qenë: Njësia Ndërlidhëse për Reagim Krizash (NJNRK), PF, KK, KM.

Faza e Katërt- Ri-dislokimi

Kjo fazë është realizuar me fillimin e kthimit të njësitë në bazë nga rajonet e grumbullimit. Kryesorja e kësaj faze është kthimi i gjendjes në normalitet, transferimi i kompetencave tek autoritetet civile lokale, kthimi i njësitë në bazë, heqja e gatishmërisë. Qëllimi përfundimtar i kësaj faze është që njësitë të jenë të gatshme për operacionet e ardhshme.

"Forca Jonë": Sa ishte kohëzgjatja e ushtrimit dhe cilat ishin incidentet e injektuara?

Kolonel Naim Haziri: Ushtrimi fushor "Shqiponja 2" ka zgjatetë (8) ditë, 24 orë dhe është zhvilluar në terren. Injektimet në total kanë qenë 52 në të dy zonat operacionale. Operacionet janë zhvilluar edhe në kushte të vështirësuar të shikueshmërisë. Në ushtrim janë angazhuar 1951 pjesëtarë, 92.9%, me gjithsej 161 automjete, duke përfshirë edhe ato jo taktike. Vlen të përmendet se në të njëjtën kohë, ne nuk i kemi ndërprerë edhe trajnimet e planifikuar më parë e që kanë qenë duke u zhvilluar nga instruktorë amerikan në Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe trajnimet jashtë vendit, si ato individuale dhe kolektive.

"Forca Jonë": Cila ka qenë mbështetja e KFOR-it, dhe shteteve të tjera që kemi marrëveshje bashkëpunimi?

Kolonel Naim Haziri: Gjatë zhvillimit të ushtrimit fushor, kemi pas një asistencë profesionale nga ekipet e oficerëve dhe nënoficerëve nga SHBA-së, të cilët kanë qenë të sistemuar në dy nivele të komandim-kontrollit. Në QBO kanë qenë kapiten Gullixson dhe OR7 Harper, Në BPO Alfa (Pejë) major Macri, OR8 Tello, OR7 Clayton, në BPO Bravo (Prizren), kapiten Cormier, OR8 Miranda, OR7 Herrera. Nga NLAT dhe ekipet mobile turke që janë marrë me trajnimin e njësitë tona, në nivel kompanie, gjithashtu kemi pas një asistencë gjatë gjithë kohës së realizimit të ushtrimit.

"Forca Jonë": Cili ishte niveli i bashkëpunimit me udhëheqësit e komunave në lokacionet e të cilëve është mbajtur ushtrimi?

Kolonel Naim Haziri: Para fillimit të ushtrimit fushor, Departamenti për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake ka bërë marrëveshje me të gjithë pronarët e pronave ku kemi zhvilluar ushtrimin, si ato private dhe publike. Jemi shumë të kënaqur me gatishmëri dhe të komunarëve dhe të qytetarëve për t'i afruar mundësi FSK-së që të realizojë ushtrimin fushor pa asnjë problem. Sigurisht që edhe ne kemi marrë obligime, që në rast të dëmtimit të pronave të tyre të bëjmë rregullimin e tyre duke i kthyer në gjendje të mëparshme.

"Forca Jonë": Ushtrimin fushor e përcollën presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, komandanti i FSK-së, Kadri Kastrati, ekupe profesionale të NATO-s, etj, cili ishte vlerësimi i tyre?

Kolonel Naim Haziri: Na gëzon fakti se, në Ditën D, për një vizitë zyrtare ishte edhe presidentja e Kosovës, znj. Atifete Jahjaga e shoqëruar nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, të cilët e vlerësuan lart ushtrimin.



Gjithashtu, ushtrimi u vlerësua lartë edhe nga vëzhguesit-kontroluesit e ushtrimit fushor si dhe nga oficerë amerikan, të cilët u shprehën se ushtrimi fushor i ka realizuar objektivat, që kanë qenë të paraparë të arrihen.

"Forca Jonë": Si drejtor i ushtrimit fushor, për fund a kemi edhe diçka për të shtuar?

Kolonel Naim Haziri: Vlen të theksohet se edhe pse ushtrimi është zhvilluar për disa ditë me radhë,

gjatë 24 orëve pa ndërprerë, duke përfshirë edhe 1/3 e operacioneve që janë realizuar natën në kushte jo edhe shumë të përshtatshme atmosferike, motivimi i pjesëtarëve ka qenë i jashtëzakonshëm. Ky fakt neve si epror të lartë, duke përfshirë edhe komandantin e KFT-së, gjeneralmajor Rahman Ramën, na jep shumë besim se ne kemi ngritë një forcë shumë profesionale, të gatshme për t'u ballafaquar me të gjitha sfidat që i kanosen vendit tonë.



Nënkolonel Jeton Dreshaj, shef i Shtabit të BRSH-së

Hera e parë që u formua Qendra e Bashkuar Operacionale në një ushtrim fushor të FSK-së



Ngritja e një Qendre të Bashkuar Operacionale (QBO) me kombinim të dy brigadave operacionale dhe mbështetjen e një-sive të specializuara ka krijuar mundësi dhe lehtësira në menaxhimin, koordinimin dhe komandimin e njësive gjatë operacioneve. Si organizim i ri, duke marrë për bazë edhe vështirësitë procedurale dhe doktrinare, QBO ka ngritur nivelin e planifikimit dhe Procesin e Marrjes së Vendimeve Ushtarake. Kjo praktikë mund të jetë organizim adekuat edhe në të ardhmen, qoftë gjatë ushtrimit fushor apo edhe gjatë operacioneve reale. Komandimi dhe udhëheqja me të gjitha njësitë pranshtabore operacionale dhe mbështetëse, ka qenë më e lehtë, për shkak të eliminimit dhe shkurtimeve të rrugës në komandim, kontroll dhe nivele komanduese. Thjeshtësia në organizime të tilla krijon lehtësira gjatë procesit të komandimit dhe udhëheqjes me njësi, gjë që ka treguar edhe puna e përbashkët në Qendrën e Bashkuar Operacionale. Bashkëngjitjet dhe shkëputjet nga vartësia, organizimi për detyra të mirëfillta ushtarake me një Qendër të Bashkuar Operacionale në nivel Operacional dhe të Bazave të Përparme Operuese në nivel taktik, ka krijuar lehtësira në kohë, gjë që është kritike në operacione të tilla dhe qartësi në vijën e komandim- kontrollit përgjatë niveleve komanduese. Gjatë ushtrimit fushor niveli i komunikimi me Drejtorinë e

Ushtrimit në KFT dhe me drejtuesit e BPO-ve, si dhe organizimi strukturor i ushtrimit, komunikimit dhe koordinimit të veprimeve ka qenë në nivelin më të lartë profesional. Gjatë procesit të planifikimit, bazuar dhe në misionin e Komandës madhore është bërë organizimi për detyrë dhe është ndërtuar Koncepti Operacional duke ndarë detyrat dhe përgjegjësitë për të gjitha njësitë operacionale, mbështetëse, si edhe për njësitë e specializuara. Zbarkimi dhe ngritja e Bazave të

Përparme Operuese (ndërtimi i kampeve) është bërë nga njësitë e FSK-së. Incidentet e ngritura gjatë UF-së kanë qenë shumë sfiduese dhe realiste, të cilat pa një planifikim dhe organizim të mirëfilltë ka qenë vështirë të menaxhohen, për shkak të intensitetit dhe natyrës së incidenteve. Çdo detyrë e dhënë nga QBO është realizuar me njësi adekuate, bazuar në Procedura Standarde Operative dhe rregullat për përdorim të forcës. Në dy bazat e Përparme Operuese të përfshirë kanë qenë mbi 600

pjesëtarë, ndërsa në gjendje gatishmërie kanë qenë 90 % e personelit të FSK-së. Ndërrimi i trupave në terren është bërë me plan përmes sistemit (operacion, gatishmëri, pushim).

Ndërsa, mbështetja e ekipeve të NATO-s, (NLAT), gjatë ushtrimit, kanë qenë në cilësinë e këshilluesve dhe vëzhguesve. Kemi pasur një bashkëpunim profesional dhe është frytdhënëse përvoja dhe profesionalizmi i këtyre ekipeve, qoftë në punën tonë të përditshme, qoftë në organizime të tilla me një

shpejtësi të lartë trajnuese. Gjatë UF-së, nga Ushtria amerikane, kemi pasur një ekip të specializuar vëzhgues dhe vlerësues të ushtrimeve të tilla. Ky ekip ka vëzhguar dhe vlerësuar në të gjitha nivelet planifikuese, komanduese të oficerëve dhe nënoficerëve, për çka edhe kanë dhënë vlerësimet e tyre në një raport të veçantë të prezantuar në KFT. Vlen të theksohet që përshtypjet e para kanë qenë shumë pozitive dhe profesionale. Procesi i mësimeve të mësuara është i rregulluar me Procedura Standarde të cilat janë në fuqi në FSK. Ne jemi në procesin e analizimit në të gjitha nivelet. Mësimet e mësuara do të publikohen gjatë Analizës Pas Vepruese dhe do të dërgohen në të gjitha nivelet. Mangësitë të cilat identifikohen, ne do të përpiqemi që përmes procesit planifikues dhe planeve të veprimit për 2014 të eliminohen dhe të mos përsëriten. Qëllimi i stërvitjeve është identifikimi i mangësive dhe nxjerrja e mësimeve të mësuara. Ushtrime të tilla krijojnë mundësi vlerësimi në të gjitha nivelet, identifikojnë mangësitë dhe u japin udhëheqësve dhe komandantëve të njësive pasqyrën e qartë të nivelit të gatishmërisë dhe të trajnimit të njësive në personel dhe pajisje. UF i fundit ka tejkaluar pritshmërinë jo vetëm timen personale, por edhe të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë ushtrim. Por sido që të jetë nuk ka vend për kënaqësi, por për vazhdim të punës profesionale dhe përkushtim në të gjitha nivelet për trajnime dhe aktivitete të ardhshme.



Komandanti i Batalionit të Parë, të BRSH-së, major Haki Xhemajli:

Planifikimi i mirë i ushtrimit fushor "Shqiponja 2" dha rezultate të larta



Batalioni i Parë i Brigadës së Reagimit të Shpejtë ka marrë pjesë me 141 pjesëtarë, të angazhuar nga kompanitë 1A dhe 1C, pastaj ekipi i koordinatoreve me 10 pjesëtarë, të angazhuar në dy zonat e operacioneve, ekipi i mbikëqyrjes nga personeli i Batalionit të Parë dhe pjesa tjetër e personelit ka qëndruar në gatishmëri gjatë gjithë kohës. Gjithashtu në këtë ushtrim kanë qenë të angazhuar edhe pjesëtarë të komuniteteve

joshqiptarë.

Batalioni i Parë në këtë ushtrim kishte për detyrë të luante rolin e forcës opozitare. Detyra kryesore ka qenë që t'i sfidojë kolegët nga njësitet tjera të FSK-së, duke simuluar incidente të ndryshme të cilat është dashur të duken sa më reale. Të gjitha incidentet të cilat i ka planifikuar Drejtorja e Ushtrimit janë ekzekutuar në terren, duke krijuar rrethana mjaft reale për dy batalionet tjera të BRSH-së dhe njësitet e specializuara të FSK-së.

Ky ka qenë ushtrimi i parë fushor i cili e ka verifikuar gjendjen reale të njësive të FSK-së, pasi edhe ekipet planifikuese edhe ekipet vlerësuese kanë qenë nga vetë FSK-ja.

Sipas zv. komandantit, major Haki Xhemajli, përgatitjet e këtij ushtrimi kanë filluar një muaj më herët, më qëllim që inskenimet të duken sa më origjinale në incidente të caktuara. Sipas tij, rezultati i batalionit të tij është arritur falë angazhimit dhe gatishmërisë së lartë të personelit. "Jam i impresionuar nga mënyra e reagimit dhe nga profesionalizmi i lartë i këtyre pjesëtarëve gjatë ushtrimit. Më lehtë është që të përgatisësh një civil për të formuar si ushtarak, se sa një ushtarak ta bësh që të harrojë standardet me të cilat është i mishëruar".

Major Xhemajli, thotë se UF "Shqiponja 2" vlerësohet si ushtrimi më i suksesshëm deri më tani falë një planifikimi shumë të mirë dhe në të njëjtën kohë është për t'u vlerësuar lartë ekzekutimi i

këtij ushtrimi. Këtë e dëshmon më së miri gatishmëria e lartë e personelit të angazhuar në ushtrim, të cilët i kanë kryer detyrat e veta në shkallën më të lartë të përgjegjësisë. „Unë marr të drejtën të them që FSK-ja është e gatshme që të evoluojë në mision dhe të marr detyra shtesë, këtë e ka dëshmuar më së miri UF" Shqiponja 2", ku edhe ekipet nga

Ajova kanë bërë komentet e tyre pozitive për rezultatet dhe të arriturat e FSK-së".

Gjatë këtij ushtrimi një rol pozitive ka luajtur edhe angazhimi i koordinatoreve, të cilët kanë pas për detyrë që të sinkronizojnë veprimet e nevojshme në përputhje me skenarin. Ky është një mësim i mësuar që ne duhet ta përdorim edhe në të ardhmen.



Nënkolonel Arsim Shaqiri

"FSK-ja do bëhet model i profesionalizmit për shumë ushtri në rajon"

Komandant i Batalionit të 3-të të BRSH-së, në Mitrovicë, nënkolonel Arsim Shaqiri, tha se: Ushtrimi i Forcës së Sigurisë të Kosovës "Shqiponja 2", tregoi edhe një herë nivelin e profesionalizmit të njësive të FSK-së; nivel ky i cili po ngritët çdo ditë e më shumë, falë punës së palodhshme të pjesëtarëve të njësive të FSK-së, si dhe trajnimeve të bëra gjatë tërë vitit për reagime dhe operacione të tilla, pasi që FSK-ja duhet të jetë çdoherë e përgatitur për t'u ballafaquar me situata të rënda. Komandanti i Batalionit të 3-të për Reagim të Shpejtë, nënkolonel Arsim Shaqiri, në ushtrimin fushor "Shqiponja 2", ishte udhëheqës i BPO-së, i cili ka pasur në vartësi 380 pjesëtarë. Batalioni i 3-të ishte bartës i operacionit dhe ka vepruar si "Task forcë" të cilit i janë bashkangjitur edhe njësitet e specializuara, si: NJNRK, Togu i Logjistikës, Togu i PF, Skuadra e Komunikimit, Skuadra e EOD-së, Skuadra e KSH, Skuadra e MKABK, Togu i Xhenios dhe një Skuadër Mjekësore. Ashtu siç e determinon doktrina dhe praktika ushtarake, kryesisht bartës të incidenteve kanë qenë komandantët e njësive manovruese, ndërsa në mbështetje i kanë pas njësitet e

specializuara, por ka pasur edhe situata të tilla ku zgjidhja më e mirë ka qenë të angazhohen vetëm njësitet e specializuara. Në këto raste komanda e incidentit i është dorëzuar komandantit të njësive specialistike në intervencim. Nënkolonel Shaqiri shprehet i kënaqur me rezultatin e jashtëzakonshme të treguar gjatë ushtrimit fushor, ku pa marrë parasysh rrethanat, pjesëtarët e FSK-së kanë arrit një sukses të shkëlqyeshëm dhe janë trajnuar e përgatitur për t'u ballafaquar me rrethana dhe kushte të jashtëzakonshme, si në nivel BPO-je ashtu edhe në nivele të njësive manovruese. Nëse vazhdojmë me ritmin e njëjtë të trajnimeve, Forca e Sigurisë së Kosovës, do të bëhet model i profesionalizmit për shumë ushtri në rajon thotë nënkolonel Shaqiri. Në ditën D të ushtrimit fushor, Batalioni i Tretë për Reagim të Shpejtë, i është bashkangjitur një ekip i mentorëve nga Ushtria amerikane me qëllim të mentorimit të personelit të Shtabit dhe Kompanive të Bat-3. Ekipi i mentorëve, përbëhet nga kapiteni Justin Cormier, oficeri luftarak Richardson, rreshter majori Rich Miranda dhe rreshter i parë Herrera. Menjëherë pas mentorimit



filleshtar që i është bërë Shtabit të Batalionit, kapiteni Cormier deklaroi se përshtypjet e para flasin se, Shtabi i Batalionit është në atë nivel profesional sa që kontributi im në këtë Shtab është shumë i kufizuar, madje kam përshtypjen gati edhe i panevojshëm. Edhe përkundër modestisë së treguar nga kapiteni Cormier, komandanti i Njësive, tha se ekipi monitorus nga Ushtria e SHBA-ve, ka dhënë një kontribut

të shkëlqyeshëm në mbështetje të Shtabit të Bat. 3-të, si në planifikim ashtu edhe në ekzekutim, gjithashtu i pazëvendësueshëm ka qenë kontributi në nivel të njësive manovruese. Në 10 ditë sa ka zgjat ushtrimi fushor, gjatë operacioneve, kanë ndodhur mbi 30 incidente të cilat kanë qenë të llojeve të ndryshme, zakonisht të bazuara në skenarë realë dhe të përzgjedhura më shumë kujdes nga drejtori i ushtrimit, ku secili

incident është menaxhuar sipas Procedurave të Vendimmarjes Ushtarake në nivel batalioni, nivel kompanie dhe më ulët, në bazë të Procedurave të Udhëheqjes së Trupave, që nënkupton së për menaxhimin e situatave të tilla janë përdorur procedurat dhe standardet më të larta ushtarake të planifikimit dhe ekzekutimit. E gjithë kjo ka rezultuar me suksesin e treguar në terren. Për fund, nënkolonel Arsim Shaqiri, tha: "Secili ushtrim i ka karakteristikat dhe specifikat e veta siç janë: terreni, pjesëmarrësit, kushtet klimatike dhe kohëzgjatja, që janë pesë karakteristikat themelore që bëjnë të dallohet secili ushtrim. Duke i pas parasysh këta faktorë, pa marrë parasysh se sa kemi përvojë në ushtrime të tilla, qasja jonë duhet të jetë e tillë sikurse në po e realizojmë këtë ushtrim për herë të parë, por nënkuptohet se përvoja jonë në udhëheqjen e operacioneve me ndikim të lartë është një lehtësim, kështu që jam mjaft i kënaqur me udhëheqjen, bashkëpunimin dhe realizimin e këtij ushtrimi fushor. Ne do angazhohemi edhe më tej në ngritjen e profesionalizmit, duke nxjerrë mësimet e mësuar dhe implementimin e tyre për operacionet e ardhshme të FSK-së".

Nënkolonel Mehmet Lladrovci: FSK-ja me sukses realizoi ushtrimin fushor "Shqiponja 2"

Ushtrimi fushor "Shqiponja 2" ka qenë mjaft sfidues, duke marrë parasysh së pjesëtarët e FSK-së deri në arrijten e Kapaciteteve Operacionale kanë ushtruar detyra të kapaciteteve fillestare në lëmin e emergjencave civile si zjarrfikje, MKAB dhe detyra të tjera. Në këtë ushtrim fushor, ata treguan përgatitjet e tyre profesionale të cilat i kishin arritur gjatë trajnimeve të shumta në bashkëpunim me Gardën Kombëtare të Ajovës, si dhe nga trajnimet tjera kolektive që janë zhvilluar në periudhën kohore nga arritja e kapaciteteve fillestare operacionale.

Gjatë tërë ushtrimit është parë se ushtarakët janë ndier të motivuar dhe me moral të lartë, gjë e cila tregon që pjesëtarët janë të trajnuar mirë, profesionist dhe po ashtu janë të gatshëm të përbushin misionin në çdo katastrofë që i kanoset vendit tonë.

Udhëheqësi i Bazës së Përparme Operative, nënkolonel Mehmet



Lladrovci, gjatë këtij ushtrimi ka menaxhuar me mbi 320 pjesëtarë, me njësi të bashkangjitura të FSK-së, si (BAT2 RSH, RMC, BMO, KDS, PFK, NJNRK, KK) dhe mbi 30 incidente me skenarë të ndryshëm me fokusim kryesor mbrojtja e rrugëve të marshit (konvojit), patrullimet, pikat e kontrollit, ndërtimi i kampit, lëvizja e njësive në terren, reagimi në kontakt, paraqitja e grupeve të keqmbësuesve, kërkim-shpëtim,

MKAB, deminim etj. Sipas, nënkolonel Mehmet Lladrovci, udhëheqja e këtij ushtrimi sa ishte atraktive po aq ishte edhe sfiduese, mirëpo ai tregon se falë një planifikimi, organizimi dhe komunikimi i cili ka qenë në nivelin më të lartë profesional kemi arritur që së bashku me pjesëtarët në vartësi ta realizojmë këtë ushtrim dhe jemi mjaft të kënaqur me të arriturat. "Parimisht jemi të kënaqur me planifikimin dhe zhvillimin e operacioneve të përgjithshme në këtë ushtrim. Njëherësh vlerësojmë se ushtrimi fushor, "Shqiponja 2" ka qenë i nivelit më të lartë të demonstrimit të kapaciteteve tona në BPO".

Gjithashtu, Lladrovci u shpreh i kënaqur edhe me komentet e Ekipit Këshillues të Ushtrisë amerikane, i cili gjatë gjithë kohës ka qenë në përcjellje të ushtrimit, ku vazhdimisht kanë dhënë komente pozitive për realizimin e ushtrimit.



FSK-ja angazhohet në kërkim e një personi të zhdukur në Komunën e Mitrovicës

Njësia e Kërkim Shpëtimit (KSH) të Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), të FSK-së, u angazhua në operacion për kërkimin e personit K.M (58 vjeçar), nga Kqiçi i Madh i Komunës së Mitrovicës, që konsiderohet i zhdukur. Operacioni ka filluar më datë: 22 tetor 2013 dhe po vazhdon edhe më 23 tetor 2013, në një lokacion të gjerë që përfshin fshatin Kqiçin e Madh

dhe fshatrat përreth tij. Angazhimi i FSK-së në këtë operacion është bërë me vendim të zëvendësministrit të FSK-së, Muhamet Latifi dhe me urdhër të Komandantit të FSK-së, gjenerallejtënant Kadri Kastrati, pas kërkesës të Qendrës së Situatave të Qeverisë së Kosovës. Operacioni i kërkim-shpëtimit është përqendruar në kërkim në ujëra dhe kërkim në male.

12 kadetë certifikohen në Kursit, Reaguesit e Parë

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS) të FSK-së, në Ferizaj, u mbajt ceremonia e certifikimit të kadetëve të Kursit Reaguesit e parë-trajno-trajnerët. Kursin, Trajno-trajnerët e kanë kryer dymbëdhjetë pjesëtarë të njësive të ndryshme të FSK-së, kursin e

kanë mbajtur instruktorë të Ushtrisë Amerikane, të Kampit, në Bonstill. Në ceremoninë e certifikimit, morën pjesë: komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, (KFT) gjeneralmajori Rrahman Rama, komandanti i Komandës

së Doktrinës dhe Stërvitjes, (KDS) gjeneralbrigade Enver Cikaçi, komandanti i Kampit në Bonstill, koloneli David WOODS, oficerë dhe nënoficerë të FSK-së, të KFOR-it Amerikan, si dhe përfaqësues të NATO-s.

